



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

THIRRJE PËR APLIKIM

Pozicioni: Këshilltar i jashtëm teknik për projektin “Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë” (Faza I - EU4Culture/UNOPS dhe FAZA II në vijim).

Muzeu Historik Kombëtar (MHK) në kuadër të projektit “Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë” (Faza I - EU4Culture/UNOPS dhe FAZA II në vijim) shapll thirrjen për Këshilltari të jashtëm teknik.

1. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Këshilltari do të mbështesë MHK-në në procesin e: (i) Analizimin e dokumentacionit përfundimtar të dorëzuar nga zbatuesit e projektit. (ii) Pjesëmarrjen në proceset e certifikimit dhe kolaudimit për të garantuar që punimet përputhen me projektin teknik dhe kontratën. (iii) Verifikimin në terren të punimeve përforcuese dhe restauruese të fasadës. (iv) Përgatitjen e raporteve teknike mbi gjendjen e objektit përpara nënshkrimit të procesverbalit të dorëzimit zyrtar tek Muzeu Historik Kombëtar. (v) Garantimin që të gjitha procedurat ndjekin kuadrin ligjor shqiptar për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit. (vi) Ekspertizë teknike në përgatitjen dhe zbatimin e fazës së dytë të projektit.

2. Kriteret e kualifikimit

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të zotërojnë diplomë në Arkitekturë ose Inxhinieri Ndërtimi.
- Të zotërojnë licencë profesionale në projektim dhe zbatim për objektet e trashëgimisë kulturore.
- Të ketë minimumi mbi 7 vite përvojë pune, me fokus në objekte të rëndësisë së veçantë të trashëgimisë kulturore.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune në pozicione të ngjashme.
- Të ketë njohje të thelluar të legjislacionit të ndërtimit në Shqipëri dhe procedurave të organizatave ndërkombëtare (si BE).

3. Dokumentacioni i nevojshëm

Të interesuarit duhet të dorëzojnë:

- a) Letër Interesi (duke specifikuar fushën e ekspertizës).
- b) CV Profesionale (detajuar me projekte të ngjashme).
- c) Kopje të Licencave Profesionale të vlefshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

d) Kopje e noterizuara e diplomave

4. Afatet dhe mënyra e aplikimit

Dokumentacioni duhet të dërgohet në rrugë elektronike në adresën muzeuhistorikkombetar@mhk.gov.al me subjektin “*Aplikim për këshilltar*” ose dorazi në zyrën e protokollit të MHK. Afati i fundit për aplikim: 24.02.2026, ora 15:00.